

V E N D I M
Nr. 477, datë 19.7.2001

**PËR LEJIMIN E IMPORTEVE TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS PËR PËRDORIM
VETJAK NGA SHOQËRITË E NDËRTIMIT, QË PUNOJNË NË PROJEKTE ME
FINANCIME TË HUAJA (“PHARE”, CBS & TRANSPORT”, “BERZH”, “BANKA
BOTËRORE” ETJ.) TË CILAT JANË PËRJASHTUAR NGA TAKSAT DOGANORE DHE
AKCIZAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me propozimin e ministrit të Transportit, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëritë kontraktore që punojnë për zbatimin e projekteve, që financohen nga donatorë apo financues të ndryshëm të huaj, me të cilët shteti ka nënshkruar marrëveshje të ratifikuara në Kuvend, të cilat parashikojnë shprehimisht, përjashtimin e importeve nga taksat ose çdo detyrim tjetër doganor, kanë të drejtë të importojnë nënprodukte nafte për përdorim vetjak, brenda periudhës së kontratës, pa paguar detyrimet për taksat doganore dhe akcizat.

2. Ministria e Transportit, në mbështetje të projekteve dhe preventivave të miratuara për investimet që përfitojnë përjashtim nga taksat doganore të importit, të paraqesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave sasisë e karburantit që konsumon secila shoqëri në vit, të ndarë në tremujorë.

3. Për çdo rast importi të karburantit, shoqëritë e mësipërme t'i paraqesin Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave kërkesën me shkrim për përjashtimin nga detyrimet doganore të importit. Kërkesa të shoqërohet me dokumentacionin argumentues të tërheqjes së sasisë së karburantit, të autorizuar më parë për përjashtimi nga taksat doganore, si dhe të një deklarate me shkrim, që kjo sasi karburanti është përdorur sipas destinacionit të miratuar.

4. Ngarkohen Ministria e Transportit, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta